



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Dragashit



Ne bazë të nenit 2,4, 10 pika 2,13,14,15 dhe 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049,nenit 12 pika c dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-040 dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit ,Kuvendi i Komunës së Dragashit, në seancën e vetë të mbajtur më 31.01.2019, miraton këtë:

R R E G U L L O R E
MBI LARTËSINË E TAKSAVE , NGARKESAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE

Dispozitat e përgjithëshme

Neni 1

1.1 Me këtë Rregullore caktohet lartësia e taksave dhe ngarkesave komunale për shërbimet që ofrojnë organet komunale personave fizik dhe juridik në lëshimin e dokumentacionit të nevojshëm nga lëmitë e ndryshme të cilat me Ligje dhe akte tjera janë vënë në kompetencë të organeve komunale.

1.2 Lëshimi i dokumentacionit të nevojshëm për palët në procedurë bëhet sipas kërkesave të cilat i parashtrorjnë qytetaret , personat juridik dhe sipas detyres zyrtare .

Neni 2

2.1 Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar në bazë të kësaj Rregullore , janë të hyra vetanake të komunës.

Neni 3

3.1 Lartësia e taksave komunale për shërbimet që kryen komuna janë në harmoni me koston për ofrimin e këtyre shërbimeve ,duke përfshi koston e punës,koston për shfrytëzimin e materjaleve dhe pajisjeve .

3.2 Lartësia e taksave dhe ngarkesave komunale është e pëcaktuar sipas skemes tarifore e cila është pjesë përbërse e kësaj Rregullore.

Neni 4

4.1.Taksat për rregullimin e dokumentacionit të ndryshëm të përcaktuara sipas kësaj Rregullore deri në shumën 10,00 euro mund të paguhen me para të gatshme në arken e komunës .

4.2. Zyrtari që pranon para të imta është i obliguar që parashtruesit të kërkesës ti lëshojë dëshminë mbi pagesën e kryer.

4.3. Ngarkesat e ndryshme te percaktuara me kete Rregullore te cilat kalojnë shumën mbi 10,00 euro paguhen ne bankat komerciale.

4.4.Parat publike te cilat grumbullohen sipas paragrafit 4.1 duhet te depozitohen brenda 24 orësh në banken komerciale.

Neni 5

5.1.Subjektet afariste të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesë së ngarkesës sipas skemes tarifoire e percaktuar ne kete Rregullore mund të kryejnë pagesën në këste.

5.2.Subjektet afariste të cilat në një mënyrë janë te regjistruara dhe nuk ushtrojnë veprimtari afariste ,mund të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës nëse më parë dëshmohet se nuk është ushtrua veprimtari afariste .

5.3.Dëshminë mbi afarizmin e subjektit afarist e lëshon Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës .

5.4.Drejtorati per Ekonomi,Financa dhe Zshvillim do të bëjë shlyerjen e subjektit afarist nga evidence vetëm pas përmbushjes së kushteve te percaktuara më lartë.

Neni 6

6.1.Të gjitha veprimtaritë afariste të cilat janë të regjistruara dhe do të regjistrohen në regjistrin e bizneseve nga 01.01.2019 deri me datë 31.12.2021 do të lirohen nga obligimi i pageses së taksës komunale në firmë, ngarkesat vjetore të veprimtarive afariste dhe profesionale sipas tarifave nr.4 të percaktuara në skemen tarifoire të rregullorës bazë.

6.2.Të gjitha subjektet afariste të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesës së taksës komunale në biznese do të lirohen nga ky obligimi në kohëzgjatje prej 2 /dy vitesh/ duke fillua nga 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

6.3. Subjektet afariste të cilat lirohen nga obligimi i pageses së taksës komunale janë të obliguara që në intervalin kohor deri më 31.12.2015 të përmbushin të gjitha obligimet e pashlyera mbi bazën e taksës komunale.

6.4.Subjektet afariste të cilat nuk veprojnë sipas pikës 6.2 të këtijë neni do të ngarkohen me taksë komunale për dy vitet e lejuara dhe organi kompetent në zbatimin e kësaj rregullore do të zhvillon procedura te parapara me ligj.

Neni 7

7.1 Nga obligimi i pagesës së taksave administrative lirohen anëtarët e familjeve të dëshmorëve,veteranët e UÇK-së (që e dëshmojnë me librezë),invalidëve të luftës dhe anëtarët e familjeve të viktimave civile të luftës në pajtim me Ligjin 04/L-054.

Neni 8

8.1. Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim – Njësia për taksa komunale dhe Njësia për regjistrim të bizneseve do të mbajnë evidencë të posaqme mbi bizneset individuale të cilat lirohen nga obligimi i pagesës së taksës komunale.

GJOBAT E TRAFIKUT DHE GJOBAT PËR SHKELJEN E RREGULLOREVE TË APROVUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS

Neni 9

9.1. Gjobat të cilat shqiptohen nga Policia e Kosovës për shkeljen e rregullave të trafikut në harmoni me Ligjin Mbi Sigurinë e Komunikacionit janë të hyra të nivelit qendror të cilat alokohen komunës varsisht nga shuma e denimeve të shqiptuara në teritorin e komunës.

9.2. Gjobat për kundërvajtje në komunikacionin rrugor janë gjoba mandatore dhe gjoba të cilat shqiptohen kundërvajtësve në procedurë gjyqësore.

9.3. Gjobat mandatore të shqiptojnë punëtorët e Policisë së Kosovës dhe lartësija e tyre është prej 15,00 deri 40,00 euro.

Neni 10

10.1. Me gjobë prej 100,00 deri 300,00 euro do të denohet për kundërvajtje subjekti afarist i cili nuk paguan ose refuzon të paguajë taksën komunale të parapare me dispozitat e kësaj rregullore.

10.2. Subjekti afarist kundër të cilit zhvillohet procedura kundërvajtëse përveç denimit të shqiptuar nga neni 10 pika 10.1 obligohet që të paguaj taksën komunale dhe shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.

10.3. Gjykata për kundërvajtje përveç denimit të shqiptuar, me vendim do të shqiptojë edhe masën mbrojtëse – ndalim i shfrytëzimit të llogarisë bankare të subjektit afarist pranë bankës komerciale. Kjo ndalesë do të vazhdojë deri sa të përmbushet obligimi mbi bazën e taksës komunale.

10.4. Gjoba e shqiptuar nga ana e Gjykatës kompetente për kundërvajtje dhe taksa komunale do të depozitohen në llogarinë bankare të komunës pranë Bankës Qendrore.

Neni 11

11.1 Me gjobë prej 100,00 euro deri 300,00 euro do të denohet personi juridik ose personi fizik i cili pa leje të organit kompetent shfrytëzon ose pengon qasjen në pronën publike. (tar.6 e Rregullores)

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 12

12.1 Mbi zbatimin e kësaj Rregullore do të përkujdesen drejtoritë komunale kompetente për grumbullimin evidentimin dhe raportimin e të hyrave në harmoni me dispozitat e Ligjit mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat financiare të leshuara nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit.

Neni 13

13.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore pushon të jetë në përdorim Rregullorja për caktimin e taksave, ngareksave dhe gjobave komunale 01 nr.06-793/1 prej 29.05.2013 dhe Aneks Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi lartësinë e taksave , ngarkesave dhe gjobave komunale 01nr.1477/3 prej 26.09.2013

Neni 14

14.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit të sajë në Kuvend, ndersa do të nënshtrohet procedurave të licencimit dhe dhënjes së pëlqimit nga Ministrinë përkatëse .

01 Nr.060/01-1393/2

Dt:31.01.2019

D r a g a s h



KUVENDI KOMUNËS DRAGASH
Kryesuesi i Kuvendit
Betim Merdiu

(Handwritten signature)

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË DHE PERSONEL
Lëshimi I çertifikatave nga sherbimi i ofiqarisë

Tarifa 1.

1.1. Për çertifikata të lindjes nga LAL.....	1,00 €
1.2. Per ekstrakt të lindjes	1,00
1.3. Për çertifikata nga LAM.....	1,00
1.4. Për çertifikata nga LAV.....	1,00
1.5. Për çertifikata mbi statusin martesor	2,00
1.6. Për Ceremoninë e martesës.....	10,00
1.7. Për çertifikata të lindjes ,martesës,vdekjes –internacionale	5,00
1.8. Për çertifikatën e nënshtetësisë.....	2,00
1.9.Per çertifikata mbi vendbanimin e qytetarit	1,00
1.10.Procedura e lidhjes së kurorëzimit jasht selisë së sherbimit ..	30,00
1.11.çertifikata tjera	2,00

Tarifa 2.

2.1. Deklerata të lëshuara në bazë te dy dëshmitarve	2,00
2.2. Deklerata mbi bashkësinë familjare	3,00
2.3. Vertetimi I fotokopjeve krahasuar me origjinalin er faqe	1,00
2.4. Vërtetim mbi mjetete per jetesë	3,00
2.5. Për gjetjen e lëndve të arhivuara sipas kerkesave	5,00
2.6. Për vertetimin e akteve te ndryshme jasht puna ne teren.....	10,00
2.7. Për vertetime mbi perkujdesjen familjare për te punësuarit në botën e jashtme të cilit fitojnë lehtësiara tatimore paguajnë ... pagesa behet per anëtarë të familjes ,	1,00

Tarifa nr.3.

3.1. Ndërrimi apo korigjimi i emrit,mbiemrit dhe vendbanimit	5,00
3.2. Regjistrimet nga bota e jashtme	5,00
3.3. Regjistrimet e mëvonëshme	3,00
3.4. Lëshimi i aktvdekjeve	5,00

Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës te zyrtari në zyren e pranimit ose në bankën komerciale.Dëshmia mbi pagesen e taksës I bashkangjitet kërkesës.

DREJTORATI PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Ngarkesat vjetore të veprimtarive afariste dhe profesionale

Tarifa nr.4

Duke pas për bazë këtë tarifë , subjektet afariste që veprojnë në teritorin e komunës së Dragashit klasifikohen në kategori dhe ate:

KATEGORIA A

4.1 Të gjitha ndermarrjet të cilat bëjnë prodhimin e lëndës së parë për përdorime të matejshme, të gjitha njisitë e kompanive regjioinale për mbeturina, ujësjellës dhe kanalizim, distribucioni për energji elektrike , Posta dhe telekomunikacioni, përfaqësitë e bankave afariste të cilat operojnë në teritorin e komunës së Dragashit, pompat e benzinës dhe bastoret sportive

KATEGORIA B

4.2 Në këtë kategori sistemohen të gjitha ndermarrjet të cilat merren me transportin e udhëtarve –autobusët, ndermarrjet për transportin e mallrave – me 2 e më shumë mjete transpoortuese, përfaqësitë e kompanive të sigurimeve , ndermarrjet për shitjen e materialit ndertimor me shumicë dhe pakicë, ndermarrjet projektuese, hotelet , motelet dhe telefonia mobile

KATEGORIA C

4.3. Në kategorinë C sistemohen të gjitha ndermarrjet tregtare, ndertimore , të gjitha ndermarrjet për shitje me pakice dhe shumicë të druve, restorantet me mbi 60m2, restorantet me muzikë të gjallë, agjencionet turistike, përfaqësitë e agjencive të huaja , rrjeti kabllorik- tv, distributorët e interneteve , supermarketet, të gjitha ndermarrjet për prodhimin e dritareve nga materiali i plastikës me xhama me vakum.

Sipas tarifës nr.4 ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste janë caktuar në shumën prej:

Kategoria A.....	300,00 euro
Kategoria B.....	200,00 euro
Kategoria C.....	150,00 euro

Ngarkesat per kategorinë D janë percaktua sipas tabelës .

KATEGORIA D

4.4. Veprimtaritë afariste që janë sistemue në këtë kategori, paguajnë ngarkesa vjetore në shumat fikse të paraqitura, si me poshtë.

Nr.tar	Veprimtaritë afariste	Shuma ne €
4.4.1	DPT për qarkullim të prodhimeve ushqimore	80,00
4.4.2	DPT për qarkullim të tekstilit –butikët ,për shitjen e parfumerisë,plastikës,libraritë .	80,00
4.4.3	DPT per qarkullim tekstilit,tepihave mbulesave ,jorganve , dyshekve etj	80,00
4.4.4	DPT per qarkullim të materialit sanitar,ujësjellësit ,mat.elektrik etj.	80,00
4.4.5	Dyqanet per shitjen e mishit dhe prodhimeve nga mishi	120,00
4.4.6.	Prodhimi dhe shitja e bukes	100,00
4.4.7	Kuzhina popullore	80,00
4.4.8.	Pizeritë	80,00
4.4.9	Kafiteritë ku nuk ofrohen pije alkoolike dhe ushqim	50,00
4.4.10	Kafiteritë ku ofrohen pije alkoolike dhe ushqim	80,00
4.4.11.	Qebaporet	80,00
4.4.12.	Ëmbëltoret	60,00
4.4.13	Burektoret	50,00
4.4.14.	Kafe-qajtore -kafe internet	50,00
4.4.15	Kiosqet	30,00
4.4.16	Punët ndertimore – ndertimi i ulet	80,00
4.4.17	Përpunimi i drurit prodhimi i dyerve ,dritareve ,orendive te ndryshme per pajisjen e kuzhinës,dhoma te fjetjes dhe te ngjajshme sipas porosisë	80,00
4.4.18	Prodhimi i dyerve,dritareve nga hekuri ,alumini dhe plastika	
4.4.19	Prodhimi dhe përpunimi I metaleve (olluqet,gilinderat etj)	80,00
4.4.20	Prodhimi i blokave dhe elementeve tjera te ndertimit nga betoni –kubëza nga rera dhe guri i bluar	80,00
4.4.21	Autoserviste ,sherbimet e kontrollit teknik te automjeteve	80,00
4.4.22	Autolarsit dhe gomisteritë	50,00

4.4.23	Elektro serviset –elektro instaluesit	60,00
4.4.24	Instalues të ujërave dhe kanalizimeve	60,00
4.4.25	Gipseret dhe fasaderët	100,00
4.4.26	Sharat-dru gëdhendësit	80,00
4.4.27	Metal përpunuesit –bravarët	80,00
4.4.28	Xhamprerësit	40,00
4.4.29	Argjentarët	100,00
4.4.30	Frizeret per mashkuj dhe femra	50,00
4.4.31	Rrobaqepësit	30,00
4.4.32	Këpuçarët	20,00
4.4.33	Fotografët	30,00
4.4.34	Transporti I udhëtarve –auto taxi (4+1)	25,00
4.4.35	Transporti I udhëtarve me kombi taksi (8+1)	50,00
4.4.36	Transporti I mallrave me vetem nji automjet transportues	80,00
4.4.37	Terenet sportive të mbyllura dhe të hapura	80,00

Shërbimet profesionale

4.4.38.	Avokatët- notarët	80,00
4.4.39	Stomatologet	80,00
4.4.40	Ordinancat private specialistike	80,00
4.4.41	Veterinarët	80,00
4.4.42	Apotekat	120,00
4.4.43	Mjekët	80,00
4.4.44	Fizeterapeutët	60,00
4.4.45	Kontabilistët	60,00
4.4.46	Laboratorët	60,00
4.4.47	Ekspertet ligjor nga lemitë e ndryshme	60,00

Veprimtaritë tjera

4.4.48	Video klubet- inqizuesit	40,00
4.4.49	Auto shkollat	100,00
4.4.50	Automatet -lojrat e ndryshme (videl lojrat)	40,00
4.4.51	Kultivimi dhe shitja ebimeve dekoruese – lulishtet	20,00

Vërejtje:Veprimtaritë afariste te paraqitur në tabelen e larteshenuar të cilat ushtrojnë veprimtaritë e veta në vendbanimet Xërrxe, Pllajnik, Zlipotok , Orqushë, Dikancë , Baqkë dhe Kerstec paguajnë taksën vjetore ne afarizëm të zvogluar për 20%.

Ndermarrjet te cilat përveq veprimtarisë kryesore kanë ne vedi edhe njësi tjera (pompë per shtjen e karburanteve ,motel,restoran,transport,fushë sportive ,pishinë dhe te ngjajshme paguajnë edhe 50% të tarifës për veprimtaritë shtesë.

TARIFA 5**DHËNIA E PASURISË KOMUNALE NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHËSHËM**

5.1.1 Dhënja në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale personave fizik dhe juridik do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit Për Dhënje Në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtëshme Komunale Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.04/L-144,dhe akteve nënligjore .

5.1.2 Per shfrytëzimin e përkohëshem te sipërfaqeve publike paguhet taksa ditore,mujore dhe vjetore

5.1.3.	Vendosja e kiosqeve dhe objekteve tjera montazhe në te cilat kryhet veprimtari tregtare	10,00
5.1.4.	Vendosja e pajisjeve per shitjen e akulloreve	4,00
5.1.5.	Vendosja e tezgave levizëse	5,00
5.1.6.	Shfrytëzimi i hapsires para objektit në te cilin kryhen veprimtari tregtare paguhet per m2	2,00
5.1.7	Shfrytëzimi i hapsires para objektit në te cilin kryhen veprimtari zejtare paguhet per m2	1,00
5.1.8.	Shfrytëzimi i siperfaqeve publike per organizimin e lojrave te fëmijëve paguhet taksa ditore e shprehur ne m2 te sip.	0,30
5.1.9.	Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike per vendosjen e gjeneratorve statik per prodhimin e rrymes paguhet tarifa mujore	5,00
5.1.10.	Shfrytëzimi i hapsires publike per shitje te shpejt nga automjeti paguhet taksa ditore për m2 te sipërfaqes së zënë	0,50
5.1.11.	Ekspozimi lipanove reklamuese paguhet taksa vjetore m/2	5,00

Vrejtje:Hapësira publike mund të shfrytëzohet pas marrje së lejes nga organi kompetent

REGJISTRIMI I PRONËSISË SË AUTOMJETEVE**Tarifa 6**

6.1.1	Per regjistrimin e pronësisë së automjetit deri 3,5 t paguhet	10,00
6.1.2.	Per regjistrimin e pronësisë së autoimjetit mbi 3,5 t paguhet	20,00

Nga ngarkesa me takës për regjistrimin e pronësisë së automjetit lirohen auomjetet e emergjencës (automjetet e zjarrfikjes dhe automjetet e ndihmës së shpejtë)

Vrejtje: Regjistrimi i Pronësisë së automjetit do të bëhet vetëm nëse pronari i automjetit ka përmbush obligimin e pagesës së tatimit në prone, në të kundërtën do të veprohet sipas nenit 5 UA 07/2011 mbi ndalimin e ofrimit të shërbimeve komunale.

DREJTORATI PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE INSPEKSION

Tarifa 7

KOMPENZIMI PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

Shuma e kompenzimit varet nga klasifikimi i tokës përkatëse .Nëse ndërrimi i kërkuar i destinimit ka të bëjë me tokën e :

- a) Klasës 1-4 kompenzimi do të jetë 1,00 € për m²,
- b) Klasës 5-6 kompenzimi do të jetë 0,75 € për m²
- c) Klasës 7-8 Kompenzimi do të jetë 0,50 € për m²

Kompenzimi i ndërrimit të destinacionit të tokës do të paguhet në procedurën administrative të marrjes së lejes së ndërtimit.

Për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore dhe bujqësore do të aplikohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.41/2006

DREJTORATI PER URBANIZEM ,KATASTËR DHE MBROJTJE TE MJEDISIT

Sherbimet katastrale dhe gjeodete

TARIFA 8

8.1.1.	Ndërrimi i kultures të një parcelë pa matje gjeodezike	10,00
8.1.2.	Për çdo parcelë tjetër që kufizohet me te	5,00
8.1.3.	Ndërrimi i kulturës në një ngastër. me matje	35,00
8.1.4.	Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	20,00
8.1.5.	Ndarja e një ngastre me dy pjesë me sipërfaqe deri 0,50 ha	50,00
8.1.6.	Ndarja e komplekseve me sipërfaqe prej 5-10 ha në dy pjesë	200,00
8.1.7.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100,00
8.1.8	Ndarja e një ngastre në më tepër se dy pjesë për çdo pjesë	40,00
8.1.9	Ndarja e një ngastre me dy pjesë me matje të pjesës së re dhe ripërtitja e kufijve	100,00
8.1.10	Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	25,00
8.1.11.	Bashkimi i dy parcelave pa matje	20,00
8.1.12.	Për çdo ngastër tjetër në kufi	10,00
8.1.13.	Ndërtesat shumëkatëshe për një ndërtesë ekonomike,	100,00
8.1.14	Objektet më të vogla që i takojnë ndërtesës shumëkatëshe për një objekt	40,00
	Ndërtesat me formë jo të rregullt (me më tepër se 4 pika) për	

8.1.15	çdo pikë plus	10,00
8.1.16	Përtrirja e kufijëve me sipërfaqe deri në 0,50 h	80,00
8.1.17	Për ngastren me sipërfaqe prej 0,50 deri 1,00 h	100,00
8.1.18	Për çdo ngaster që kufizohet me te plus	50,00
8.1.19	Për rrugë, kanale në gjatësi gjerë me 100 m	150,00

Vrejtje: Palës i lëshohet vendimi dhe skica në të cilën shifet përtrirja e kufijëve

8.1.20	Punet në matje sipas kërkesave të posaqme –bartja e planeve urbanistike në terren për një ngaster	80,00
8.1.21	Puna në zyrë për ndarjen e ngastres sipas planeve urbanistike –për një ngastër	20,00
8.1.22	Shënimi i vijës së rregullacionit të rruges -për një meter	0,50
8.1.23	Shënimi i kufijve në terren me rastin e shpronësimit –bartja e planeve urbanistike për një ngaster	80,00
8.1.24	Identifikimi i ngastrave dhe objekteve katastrale në zyrë-identifikimi I numrave të ngastrave dhe pronarve për një ngaster	10,00
8.1.25	Për çdo ngastër tjetër	5,00
8.1.26	Identifikimi i një ngastre pa matje -për një ngastër	30,00
8.1.27	Identifikimi i një parcele-krahasim i gjendjes me të vjetrën	15,00
8.1.28	Pëpilimi i skicave për strukturën e banesës-ndërtesës	40,00
8.1.29	Matja e gypave, përquesëve elektrik dhe përçojave tjera –për një metër gjatësi	0,80
8.1.30	Koordinatat,lartësia mbidetare,pershkrimi i pozites për një pikë	10,00
8.1.31	Vendosja e një pike gjeodezike –stacion i lirë	30,00
8.1.32	Për çdo pikë tjetër edhe nga	10,00
8.1.33	Kopja e planit katastral me paraqitje vertikale –për planin në shkallë 1:500	20,00
8.1.34	Për planin në shkallë 1:1000	20,00
8.1.35	Për planin në shkallë 1:2500	20,00
8.1.36	Për planin në shkallë 1:5000	20,00
8.1.37	Shërbimet administrative –lëshimi i fletave poseduese për fletën e parë	4,00
8.1.38	Ndersa për çdo fletë tjetër të fletës poseduese	2,00
8.1.39	Çertifikatat – për një certificate	3,00
8.1.40	Regjistrimi,ndërrimi bartja apo fshirja e poseduesit të ri, apo të drejtave mbi paluajtshmerinë	20,00
8.1.41	Kopja e planit formati A-4, për një kopje	5,00
8.1.42	Kopja e planit formati A-3, për një kopje	7,00
8.1.43	Punët tjera sipas kërkesave të palëve -puna në zyrë, për një orë	10,00

8.1.44	Regjistrimi i pronësisë do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve –për vlerën deri 10.000 euro paguhet taksa prej	20,00
8.1.45	Për vlerën e transakcionit prej 10.000 deri 20.000 euro	30,00
8.1.46	Per vlerën e transkacionit prej 20.000 deri 40.000 euro	40,00
8.1.47	Per vlerën e transakcionit prej 40.000 deri 50.000 euro	50,00
8.1.48	Mbi vlerën 50.000 euro për çdo tejkalim paguhet vlera 10 euro, por shuma e taksës së përgjithëshme nuk mund të kaloj shumën prej	200,00
8.1.49	Po që se vlera e kontratës –transakcionit është e pavlefshme paguhet taksa në vlerë prej	70,00
8.1.50	Nëse në dokumentin –kontratën mbi dhurimin e pronës së paluajtëshme është caktue vlera e pronës në këto raste do të paguhet taksa per çdo posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit nga tarifa 9.1.55 deri 9.1.59	
8.1.51	Nëse në dokumentin –kontratën mbi dhurimin e pronës së paluajtësme nuk është caktue vlera e pronës në këto raste do të paguhet taksa në shumën prej 40,00 euro për çdo pronar që e fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit	40,00
8.1.52	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor,bëhet duke pague taksën në shumën prej	80,00
8.1.53	Regjistrimi i pronësisë së posedimit në bazë të pjestimit – ndarjes së pronës në bashkëpronësi bëhet duke paguar shumën prej 20 euro për secilin person që bëhet pronar – posedues i pronës.	
8.1.54	Regjistrimi i pronësisës ,posedimit në bazë të trashigimisë behet duke pague shumën prej 20 për çdo trashigimtar.	
8.1.55	Regjistrimi i pronësisë ,posedimit në bazë të shkputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20 euro për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar-posedues.	
8.1.56	Regjistrimi i pronësisë ,posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme bëhet duke paguar taksën në shumën prej 50,00 euro për secilin pronar-posedues.	
8.1.57	Regjistrimi i hipotekave behet sipas vlerave të kredive dhe atë ne vlerën deri 5.000 euro paguhet taksa 20 euro, Në vlerën 5.000 deri 10.000 euro paguhet 30 euro, Në vlerën 10.000 deri 20.000 euro paguhet 50 euro Në vlerën 20.000 deri 40.000 euro paguhet 70 euro Mbi vlerën 40.000 euro paguhet për çdo tejkalim edhe nga 20 euro por shuma e tarifës së taksës nuk mund të kaloj shumën prej 300 euro.	

8.1.58	Per vendimin mbi fshirjen e hipotekës nga regjistri i të drejtave mbi pronën e paluajtëshme paguhet taksa	20,00
--------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------

Vrejtje :Për çmimet e shërbimeve katastrale të cilat nuk janë përfshir në këtë rregullore do të aplikohen çmimet nga UA 06/2008 Për Tarifat e Shërbimeve dhe të Produkteve Katastrale të ofruara nga Zyra Katastrale e Komunës.

Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshi në këtë Rregullore do të regjistrohen duke paguar taksën prej 40,00 euro.

Shërbimet kadastrale dhe gjeodete nuk do të ofrohen personave fizik dhe juridik, nëse më parë nuk është përmbushur obligimi i pagesës së tatimit në pasurinë e paluajtëshme-tatimi në pronë (Neni 3.pika 2 UA 07/2011 Për Urdhëresat e Ndalimit të Shërbimeve Komunale Për Detyrimin e Pagesës së Tatimit në Pronë.

Shërbimet nga lëmija e urbanizmit dhe mbrojtja e ambientit

Tarifa 9

9.1.1	Kërkesat ,ankesat dhe kundërshtime të ndryshme nga lëmia e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor	1,00
9.1.2.	Kërkesa për lëshimin e kushteve ndërtimore	10,00
9.1.3.	Leje për ndërtimin e ndërtesave individuale dhe kolektive paguhet për m/2 të ndërtimit	1,61
9.1.4	Leje për shëndërrimin e lokaleve banesore në lokale afariste paguhet taksa per m/2	1,61
9.1.5	Leje për ndërtimin e garazhave ,për objektet montazhë dhe kiosqet paguhet per m/2	1,61
9.1.6	Leje për objektet afariste të montuara paguhet per m/2	1,61
9.1.7	Leje për objektet levizëse	20,00
9.1.8	Lëshimi i çertifikatave dhe vërtetimeve	2,00
9.1.9	Pranimet teknike të objekteve individuale deri 300 m/2	50,00
9.1.10	Pranimet teknike të objekteve individuale mbi 300 m/2	100,00
9.1.11	Për ndërtimin e objekteve afariste –ekonomike dhe objekteve tjera per sipërfaqe të mbuluara për m/2	1,61
9.1.12	Për sipërfaqe të hapura deri 500 m/2	1,61
9.1.13	Lejet e ndërtimit per objekte individuale në fshat paguhet për m/2	1,61
9.1.14	Lejet për ndërtimin e objekteve bujqësore për m/2	1,61
9.1.15	Leje për gropime të ndryshme të rrugëve , trotoareve dhe shesheve për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, ujesjellësit, rrymës, instalimet e rrjetit kabllor, rrjetit të PTT etj. paguhet për metër gjatësi	0,50

9.1.16	Dëmtimi i rrugëve ,trotoareve dhe pasurisë tjeter publike m/2	10,00
9.1.17	Dëmtimi i rrugëve ,trotoarve nga asfalti,kubëzat m/2	2,00
9.1.18	Dëmtimi i kanalizimit,ujësjellësit dhe instalimeve tjera metër gjatësi	1,00

DREJTORATI PER SHENDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

Tarifa 10

Bashkëpagesat nga lëmia e shëndetësisë paraqesin të hyra vetanake te dedikuara për instucionet shëndetsore, Tarifat e shërbimeve shëndetësore janë të përcaktuara sipas UA 6/2006 duke rregulluar në mënyre unike pagesat në gjithë sistemin publik të shëndetësisë në Kosovë

10.1.1.	Ekzaminimi mjekësor ne AMF,QMF ose ne QKMF ,pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1,00
10.1.2	Ekzaminimi specialistik ne QMF/QKMF me udhëzim të mjekut	2,00
10.1.3	Ekzaminimi specialistik ne QMF/QKMF pa udhëzim te mjekut te familjes	4,00
10.1.4	Ekzaminimi në shtëpi përpos në raste emergjente	6,00
10.1.5	Medikamente nga lista esenciale ,ofruar ne barnatoren publike	0,30
10.1.6	Ultrazëri standard	2,00
10.1.7	Radiografia	2,00
10.1.8	Analiza laboratorike -vetëm hemogrami dhe urina	1,00
10.1.9	Analiza laboratorike -komplet	3,00
10.1.10	Caktimi i sheqerit ne gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1,00
10.1.11	Audiogrami	1,00
10.1.12	Shpërlarja e veshit	1,00
10.1.13	Dhënja e injeksionit intramuscular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1,00
10.1.14	Dhënia e injesionit intravenoz në shtëpi ,përpos në raste emergjente	1,00
10.1.15	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri ne shërim të plagës vetëm në vizitën e pare	3,00
10.1.16	Trajtimi ditor me infusione në institucionin shëndetësor	1,00
10.1.17	Çertifikata per leje të vozitjes e lëshuar nga konziliumi i profesionistëve	18,00
10.1.18	Çertifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18,00
	Dhënia e raportit mjekësor,vërtetimit apo dokumentit tjetër	

10.1.19	në bazë të kërkesës së shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore	5,00
10.1.20	Ofrimim i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj., për një orë	25,00
10.1.21	Vizita e parë stomatologjike	1.00
10.1.22	RTG i dhëmbit	1.50
10.1.24	Mbushje e përhershme me amalgam	4.00
10.1.25	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00
10.1.26	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00
10.1.27	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.1.28	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.1.29	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.1.30	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.1.31	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme(amalgamë apo kompozitë)	6.00
10.1.32	Rindertimi i konzevatit i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00
10.1.33	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
10.1.34	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
10.1.35	Vulosja e fisurave	1.00
10.1.36	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
10.1.37	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
10.1.38	Kiretazha e xhepave paradontal (një dhëmb)	1.00
10.1.39	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
10.1.40	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50
10.1.41	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
10.1.42	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50
10.1.43	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi në raste emergjente	1,00

Përrjashtimet nga bashkëpagesat:

- 1.Përrjashtohen nga lista e bashkëpagesave të gjitha shërbimet shëndetsore dhe grupet e veqanta të populates ,në harmoni me nenin 22.të Ligjit për shëndetësi nr.4/2004.
- 2.Sherbimet shëndetsore dhe grupet e populates ,te liruara nga bashkëpagesat janë:
 - fëmijët dhe të rinjtë deri ne moshën 15 vjeçare ,
 - Nxënësit dhe studentët deri në fund të shkollimit të rregullt,

- Qytetarët mbi moshën 65 vjeçare,
- Qytetarët, anëtarët e ngusht të familjeve të dëshmorëve, invalidet e luftës, veteranëve të UÇK-së (që e dëshmojnë me librezë) dhe llojet e tjera të invaliditetit ,anëtarët e të familjeve të tyre si dhe shfrytëzuesit e skemave të përgjithëshme të perkrahjes sociale dhe anëtarët e ngusht te familjeve të tyre,
- Personat me aftësi të kufizuara ,
- kujdesi shëndetësor parandalues,
- Kujdesi shëndetësor reprodaktiv,që përfshin masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin shëndetësor gjatë shtatëzansisë,lindjes dhe lehonisë,
- kujdesi shëndetësor për qytetarin në stadin terminal duhet te ofrohet në shtepinë e qytetarit nga ana e qendres së mjekësisë familjare.

Tarifa nr.11

SHËRBIMET QË OFROHEN NGA QENDRA PER PUNË SOCIALE

11.1.1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Kosovës	3,00€
11.1.2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	3,00€
11.1.3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe e veprimit	1,00€
11.1.4	Pëlqim për martesë para moshës madhore	3,00€
11.1.5	Vertetim që nuk është shfrytëzues indihëmave sociale	1,00€
11.1.6	Pëlqim për përfaqësim në Gjykatë për fëmijët për trashigimi,nënshkrim të kontratave të ndryshme etj.	1,00€
11.1.7	Vërtetim që pala nuk është nën përkujdesjen e kujdestarit të përkohëshëm ligjor	1,00€
11.1.8	Pëlqim për udhëtime jasht vendit për fëmijët	2,00€
11.1.9	Pëlqim për bashkim familjar me prindin ose prindërit e tyre që jetojnë jasht vendit	2,00€
11.1.10	Mendimi për adoptim	5,00 €

11.1.11	Konstatime te ndryshme	1,00€
11.1.12	Vërtetim që nuk merr ndihmë (shtesa për fëmijë)	1,00€
11.1.13	Pëlqim për dokumente të udhëtimit	1,00€

DREJTORATI PER KULTURË

Tarifa 12

12.1.1.	Shfrytëzimi i sallës ne shtëpinë e kulturës me rastin kërkesës së personave juridik ,organizatave tjera dhe partive politike ne shpalesjen e programeve partiake dhe manifestimeve te ndryshme, me zërim	60,00
12.1.2.	Shfrytëzimi i pajisjeve të zërimit jasht sallës	60,00

01 Nr.060/01-1393/2

Dt.31.01.2019

D r a g a s h

KUVENDI I KOMUNËS DRAGASH

Kryesuesi I Kuvendit

Betim Merdiu

